



**KOMPANIA RAJONALE E UJËSJELLËSIT
SH. A.**



Zyret qendrore
Rr. Lekë Dukagjini Nr. 156 30000 Pejë
Telefoni: 039 / 432 355
www.hidrodrini.com

Duke u bazuar në nenin 21.4 të Ligjit Nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.04/L-111, Bordi i Drejtorëve i K.R.U. "Hidrodrini" Sh.A. - Pejë, në mbledhjen e rregullt të mbajtur më dt. 31.08.2026, pas shqyrtimit dhe diskutimit lidhur aplikimet e kandidatëve të konkursit për pozitën e Sekretarit, njëzëri mori këtë:

V E N D I M *nr. 78*

I. ANULOHET Konkursi Publik nr. 1566, datë 16.07.2026, për pozitën Sekretar në K.R.U. "Hidrodrini" Sh.A. – Pejë.

II. Konstatohet se, pas shqyrtimit dhe vlerësimit të dokumentacionit të aplikimit, asnjëri nga kandidatët nuk i ka plotësuar kriteret minimale të kërkuara për pozitën, përkatësisht kriterin e përvojës së konsiderueshme profesionale nga fusha e qeverisjes korporative.

A r s y e t i m

Bordi i Drejtorëve i K.R.U. "Hidrodrini" Sh.A., Pejë, ka shpallur konkurs publik nr. 1566, datë 16.07.2026, për plotësimin e pozitës Sekretar. Pas përfundimit të afatit të aplikimit, Bordi i Drejtorëve shqyrtoi dokumentacionin dhe vlerësimin e kandidatëve në raport me kriteret e përcaktuara për pozitën.

Bordi i Drejtorëve në mbledhjen e rregullt të mbajtur më 31.08.2026, Pas shqyrtimit konstatoi se asnjëri nga kandidatët nuk e plotëson kriterin minimal të përvojës së konsiderueshme profesionale nga fusha e qeverisjes korporative, kriter ky që buron nga neni 21.4 i Ligjit për Ndërmarrjet Publike. Bordi vlerësoi se, për shkak të natyrës dhe përgjegjësive të pozitës, procedura nuk mund të vazhdojë me kandidatë që nuk i plotësojnë kriteret minimale të kërkuara.

Për këto arsye, Bordi i Drejtorëve, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryesuesja e Bordit të Drejtorëve
Qendresa Kukaj – Prelvukaj



Ju dërgohet:

- Bordit të Drejtorëve;
- NjPMNP-së;
- Arkivit.